



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Biznes dhe Ekonomi (2019/2020)**

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180
Kodi	FB-180
Titulli	I diplomuar në biznes dhe ekonomi / Drejtimi: Financat dhe Bankat
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-18/2
Vendimi për fillim me punë	03-18/4 (07.06.2019)
Data akreditimit	02.04.2019

Përshkrimi i programit

Programi studimor Biznes dhe Ekonomi - Financat dhe Bankat paraqet kombinim të baraspeshuar të njohurive bazë teorike dhe të shkathtësive specifike profesionale. Struktura e programit përfshin studime të cilat nga natyra janë dinamike dhe interaktive. Programi është i dizajnuar të ofrojë tema nga lëmia e ekonomisë, financave dhe menaxhmentit, duke bërë implementimin e konceptit në fjalë përmes programit studimor. Lëndët, të cilat janë të përfaqësuara në këtë program paraqesin perspektiva të cilat bazohen mbi teorinë, e cila është e ndërlidhur ngushtë me implementimin praktik në botën e biznesit. Ky program u mundëson studentëve përvetësim të aftësive dhe përvojave të nevojshme për: teorinë ekonomike, analizat e ndryshme financiare nga sektori bankar, analizat ekonometrike të të dhënave dhe interpretimin e të njëjtave, si dhe përdorimin e njohurive të menaxhmentit gjatë sjelljes së vendimeve menaxheriale.

Programi studimor ka për qëllim:

- T'i përgatisë studentët për pozita të liderëve në organizata profitabile apo joprofitabile në vend dhe çdo kund në botë.
- T'i përgatisë studentët për ndërtim të karrierës në lëmin e ekonomisë dhe menaxhmentit, por edhe të sektorit privat në lëmin e financave.
- Të mundësojë përvetësim të aftësive dhe përvoja hulumtuese për: teorinë ekonomike, përdorim të menaxhmentit, financave, si dhe analizë ekonometrike të të dhënave.
- Ta zhvillojë konceptin e punës praktike tek studentët.
- Ta zhvillojë konceptin e të menduarit kritik tek studentët.
- T'u mundësojë studentëve të kyçen në mënyrë aktive në ligjëratat me qëllim që në mënyrë të pavarur t'i kryejnë hulumtimet në të gjitha fushat e ekonomisë dhe menaxhmentit.
- Të mundësojë zhvillim të aftësive personale, komunikuese, hulumtuese dhe aftësive të tjera që janë të rëndësishme për punësim.

Gjatë kohës së studimeve, studentëve u jepen mundësi për punë praktike (internship), me çka ata do të aftësohen t'i implementojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë lëmi.

Karriera

Programi studimor do t'u mundësojë studentëve:

- Të fitojnë një arsimim të përgjithshëm në disiplina që e nënvizojnë teorinë dhe praktikën e menaxhmentit ndërsa nga ana

tjetër ende ngelen të specializuarit në ekonomi.;

- Të ndërmarrin studim të thelluar të ekonomisë me opsionet e menaxhmentit që do t'u mundësojë të shikohen në mënyrë kritike çështjet e menaxhmentit;
- Të fitojnë trajnim në parimet e ekonomisë dhe aplikimeve të tyre;
- Ta kuptojnë se menaxhmenti është një shkencë me bazë të gjerë sociale dhe fushë multidisiplinare;
- Të njihen me mjetet e përshtatshme të analizës për të trajtuar çështje dhe problematika të politikave ekonomike;
- T'i kuptojnë organizatat, aspektet kyçe të Menaxhmentit të tyre dhe ambientin e jashtëm në të cilin ato operojnë;
- Të kenë një mjedis ku ata mund t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre interpersonale dhe komunikative;
- Të kenë një bazë të fortë për studime të mëtejshme dhe për punësim.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të nevojshme për funksionet biznesore, si në vijim: ekonomi, menaxhment, financa, biznes dhe menaxhment në kontekstin global, parimet e kontabilitetit, financat e korporatave, menaxhmentin strategjik, menaxhmentin e burimeve njerëzore dhe marketing;
- Ka njohuri të fushave funksionale të ekonomisë dhe menaxhmentit, hulumtimet dhe inovacionet aktuale, trendet e ardhshme, si dhe ndikimin e këtyre ndodhive në teori dhe praktikë.
- Ka njohuri dhe të kuptuarit e situatës kombëtare, rajonale dhe globale ekonomike në treg;
- Ka njohuri të teorive menaxheriale, analizave dhe raportimeve;
- Fiton një bazë të fortë për atë se si të zhvillohet më shpejt ekonomia dhe është i gatshëm për karrierë dhe studime postdiplomike, që kanë të bëjnë me ekonominë dhe menaxhmentin, ose me drejtime tjera të përafërta;
- Ka njohuri për mjetet e ndryshme të nevojshme për marrjen e vendimeve menaxheriale;

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aftësi për të shkruar në mënyrë profesionale dhe zhvillim të mëtutjeshëm të detyrave në ekonomi dhe menaxhment dhe implementimi i tyre në jetën reale;
- Aftësi për të ndihmuar në formulimin dhe zbatimin praktik të planeve të suksesshme të Menaxhmentit të përgjithshëm dhe strategjive;

Aftësitë për të vlerësuar

- Të mendojnë në mënyrë kritike dhe t'i aplikojnë dijet teorike dhe praktike dhe përvojën për identifikimin dhe analizën e problemeve ekonomike;
- Të analizojnë në mënyrë kritike dhe ta vlerësojnë identifikimin e mundësive menaxheriale;

Aftësitë e komunikimit

- Të tregojnë se e kuptojnë dinamikën individuale dhe grupore;
- Të funksionojnë në mënyrë efikase në punën ekipore;
- Të merren në mënyrë efektive me njerëz që kanë prejardhje të ndryshme në aspektin shoqëror, ekonomik, kulturor dhe fetar;
- Të demonstrojnë mirëkuptim dhe ndjeshmëri për përgjegjësitë etike, sociale dhe ligjore të kompanive;
- Të shfaqin idetë e biznesit në mënyrë efektive;
- Të demonstrojnë aftësi kyçe negociuese;
- T'i interpretojnë të dhënat e biznesit dhe treguesit ekonomikë;

Aftësitë e të mësuarit

- Mund të hulumtojnë dhe t'i dektektojnë burimet e të mësuarit;
- Mund të trajnohen për mësim individual dhe ekipor;
- Kanë aftësinë për të përdorur literaturë shkencore dhe të bëjnë analiza të opinionëve dhe vlerësimeve të autorëve të tjerë;

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [CBE-102] [6.0 SETK] **Parimet e Marketingut**
- [CBE-103] [6.0 SETK] **Parimet e Menaxhmentit**
- [BE-401] [6.0 SETK] **Parimet e Bankierisë dhe Financave**
- [3.0 SETK] **Gjuhë Shqipe/Maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë Angleze**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Gjuhë, Shkathtësi ose Kulturë)**

Semestri 2

- [CBE-201] [6.0 SETK] **Parimet e Kontabilitetit**
- [CBE-202] [6.0 SETK] **Matematikë Biznesi**
- [CBE-203] [6.0 SETK] **Mikroekonomi**
- [3.0 SETK] **Gjuhë Shqipe/Maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë Angleze**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Gjuhë, Shkathtësi ose Kulturë)**

Semestri 3

- [CBE-301] [6.0 SETK] **Statistika**
- [CBE-302] [6.0 SETK] **Kalkulus Biznesi**
- [CBE-303] [6.0 SETK] **Makroekonomia**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Gjuhë, Shkathtësi ose Kulturë)**
- [6.0 SETK] **Gjuhë Angleze për Qëllime Specifike 1**

Semestri 4

- [CBE-401] [6.0 SETK] **Menaxhmenti i Operacioneve**
- [CBE-402] [6.0 SETK] **Kontabiliteti Financiar**
- [BE-402] [6.0 SETK] **Bazat e Ekonometrisë**
- [6.0 SETK] **Gjuhë Angleze për Qëllime Specifike 2**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Gjuhë, Shkathtësi ose Kulturë)**

Semestri 5

- [EBEM-507] [6.0 SETK] **Kontabiliteti Menaxherial**
- [CBEF-502] [6.0 SETK] **Ekonomia Monetare**
- [BE-501] [6.0 SETK] **Financat e Korporatave**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Gjuhë, Shkathtësi ose Kulturë)**

Semestri 6

- [EBE-406] [6.0 SETK] **Menaxhmenti i Investimeve**
- [CBEF-602] [6.0 SETK] **Financat Publike**
- [EBA5090] [6.0 SETK] **Ekonomia e Dijes**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (Profesionale)**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Parimet e Marketingut**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njohohen me konceptet themelore, të cilat janë ndërtuar në funksionet e marketingut në organizatat bashkëkohore. Fokusi është vendosur në konceptet, si dhe në çështjet lidhur me marketingun e prodhimeve dhe shërbimeve të konsumatorëve. Në mënyrë më specifike, qëllimi është që studentët ta njohin mjedisin e marketingut nëpërmjet analizës së tregut, që pastaj të implementohen strategjitë e suksesshme të marketingut në atë mjedis. Studentët gjithashtu, do të mund t'i implementojnë konceptet shkencore për dizajnimin e planit të marketingut për produktin e tyre. Kjo lëndë u mundëson studentëve të njohohen me aktivitetet e ndryshme

në fushën e marketingut, të cilat kontribuojnë që kompania të jetë më konkurrense dhe më e suksesshme në treg.

- **Parimet e Menaxhmentit**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njoftohen me bazat e menaxhmentit, gjenezën dhe përkufizimin e tij, si dhe me parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm. Ndjekja e kësaj lënde ka për qëllim që studentët të përfitojnë njohuri themelore nga fusha e funksioneve bazike në menaxhment si planifikimi, organizimi, koordinimi, motivi dhe kontrolli. Të mësuarit e kësaj lënde studentëve do t'u mundësojë: t'i mësojnë bazat e menaxhmentit dhe të aftësohen për to që të japin shembuj konkretë, të aftësohen ta shohin këtë lëndë si nevojë për fitimin e njohurive që do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar, të mendojnë në mënyrë efikase që do t'u ndihmojë të përballen me problemet afariste në jetën e tyre të mëtutjeshme.

- **Parimet e Bankierisë dhe Financave**

Qëllimet e programit të lëndës: - Diskutim në lidhje me arsyen e ekzistimit të sistemeve financiare dhe si janë ato strukturuar; - Të kuptohet pse rëndësia relative e ndërmjetësve financiarë dhe tregjeve financiare mbarë botës është e ndryshme, dhe si sistemet e bazuara në banka ndryshojnë nga sistemet e bazuara në treg; - Të kuptohet pse ekzistojnë ndërmjetësit financiarë dhe diskutime rreth rolit të kostove të transaksionit dhe teoritë e asimetrisë së informacionit për justifikimin ekonomik; - Të kuptohet pse bankat kanë nevojë për rregullatore, dhe iustrimin e arsyeve për dhe kundër rregullimit të sistemeve bankare; - Të diskutohet rreth llojeve kryesore të rreziqeve me të cilat ballafaqohen bankat dhe përdorimi i teknikave kryesore që shfrytëzohen nga bankat për të menaxhuar rreziqet; - Të kuptohet se si të vlerësoni asetet reale dhe asetet financiare, dhe të përdorimi i teknikave kyçe të buxhetimit (Vlera neto e tashme dhe norma e brendshme ose kthimi); - Të kuptohet si bëhet e vlerësimi i mjeteve financiare (obligacioneve dhe stoqeve); - Capital Asset Pricing Model.

- **Parimet e Kontabilitetit**

Qëllimi i programit të lëndës është t'u ndihmojë studentëve ta kuptojnë thelbin e kontabilitetit, t'i mësojnë bazat e kontabilitetit financiar, konceptet dhe parimet e kontabilitetit. Në mënyrë më specifike, studentët të fitojnë njohuri dhe t'i kuptojnë raportet financiare, komponentët e tyre, rregullat themelore të evidentimit të të dhënave kontabël, përdorimin e dokumenteve kontabël.

- **Matematikë Biznesi**

Qëllimet e lëndës janë si në vijim: - Studentët të aftësohen ta zbatojnë sistemin e ekuacioneve lineare për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga lëmi i biznesit dhe ekonomisë; - Studentët të aftësohen t'i zbatojnë njohuritë e tyre për modelet lineare dhe vargjet e shumta për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në biznes dhe ekonomi; - Studentët të fitojnë njohuri të avancuara në përlogaritjen e shkallës së ndërlikuar të kamatës, depozitave periodike, të rentave periodike, huave dhe vendimeve financiare.

- **Mikroekonomi**

Nëpërmjet kësaj lënde arrihen njohuri themelore për fenomenet ekonomike dhe për terminologjinë universale globale mikroekonomike. Ndiqen dhe analizohen qasjet teorike që mundësojnë të arrihet pasqyra vetanake për zgjidhjet e mundshme aplikative për problemet e prodhimit, këmbimit dhe organizimit të ndërmarrjeve individuale, degës ose tregut të veçantë. Komponentët e zhvillimit japin një dimension dinamik pa të cilët qasjet më pak komplekse do të ishin të papërdorshme. Bazat e mikroekonomisë mësohen në tërë botën si pjesë e përpjekjeve universale që të përafrohen dhe të definohen problemet e ngjashme dhe të vijë deri te mundësia që ato të zgjidhen në mënyra të ngjashme gjithkund në botë, por edhe për të ardhur deri te informacionet të cilat mundën në nivelin agregat të ndihmojnë në formulimin e qëllimeve makroekonomike dhe të elementeve strategjike të planifikuara. Kjo është pjesë e nevojës që të ndërtohen shoqëri të ngjashme globale në të cilat kontaktet e shpeshta biznesore, politike, afariste do të jenë të njohura për të gjithë pjesëmarrësit dhe do të zgjidhen në të njëjtën mënyrë duke përdorur instrumente të njëjta komplementare të cilat gjithkund janë të përdorshme.

- **Statistika**

Qëllimi i programit është që studentët të fitojnë njohuri që të jenë të aftë: - Ta përdorin analizën deskriptive gjatë analizës së të dhënave; - Ta përdorin gjasën dhe ndryshimet e rastit në zgjidhjen e problemeve të biznesit; - Ta kuptojnë përfundimin statistikor i cili paraqet bazë për interpretimin e rezultateve dhe sjelljen e vendimeve afariste; - T'i shfrytëzojnë korrelacionin dhe regresionin e thjeshtë dhe të përbërë; - T'i dinë bazat e analizës së variancës; - T'i kuptojnë bazat e numrave indeksues dhe metodat e analizës së serive kohore; Parakushte për ta regjistruar këtë lëndë: Matematika e biznesit.

- **Kalkulus Biznesi**

Qëllimi i programit është t'i aftësojë studentët: - Të dëshmojnë që kanë njohuri dhe kuptim për varësitë ndërmjet madhësive, të cilat zbatohen në biznes dhe ekonomi dhe në modelet e thjeshta matematikore; - T'i identifikojnë relacionet ndërmjet kalkulusit diferencial dhe funksionet e biznesit dhe ekonomisë; - T'i aplikojnë këto relacione për studimin e varshmërive ndërmjet madhësive në biznes dhe ekonomi; - Ta aplikojnë kalkulusin diferencial për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të cilat aplikohen në biznes dhe ekonomi. Parakushte për ta regjistruar këtë lëndë: Matematikë Biznesi.

• **Makroekonomia**

Studenti të do të përfitojnë njohuri për: - Termet dhe kategoritë makroekonomike, të cilat janë parakusht për funksionimin e një ekonomie nacionale, e cila është pjesë e një sistemi të zgjeruar ekonomik global; - Rëndësinë e indikatorëve kryesorë makroekonomikë, siç janë: bruto prodhimi kombëtar, të ardhurat kombëtare, rritja ekonomike, ciklet ekonomike, investimet dhe harxhimet publike, inflacioni, papunësia, paratë dhe bankat, buxheti, bilanci i pagesave. etj.; - Instrumentet themelore të analizës makroekonomike (oferta dhe kërkesa agregate) dhe politikat makroekonomike (politika monetare dhe fiskale) etj.; - Funksionimi efikas i një ekonomie kombëtare, krahasuar me ekonominë bashkëkohore të tregut, duke evidentuar në atë drejtim dallimet, ngjashmëritë dhe mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë përkatëse; - Njohuritë nga fusha e makroekonomisë, që do t'u mundësojnë qasje të thjeshtësuar kah lëndët tjera të avancuara makroekonomike. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Hyrje në ekonomi, Mikroekonomi.

• **Menaxhmenti i Operacioneve**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri për t'u aftësuar: - Të përgatisin dhe të sjellin vendime me të cilat realizohen prodhimet dhe shërbimet; - Të përgatisin dhe të sjellin vendime me të cilat kontrollohen prodhimet dhe shërbimet; - Të gjejnë një qasje të përshtatshme për zgjidhjen e secilës situatë lidhur me problemet komplekse të prodhimeve dhe shërbimeve; - T'i mësojnë aktivitetet e ndryshme në organizatë dhe funksionimin e sistemit në tërësi të Menaxhmentit operativ; - Të përgatisin dhe të sjellin vendime me të cilat krijohen kushte për prodhimet dhe shërbimet. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e Menaxhmentit.

• **Kontabiliteti Financiar**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'u mundësojë studentëve dije më të avancuar në fushën e kontabilitetit dhe implementimin e saj në sistemin kontabël të entiteteve biznesore. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e Kontabilitetit.

• **Bazat e Ekonometrisë**

Qëllimi i lëndës është që të mësohen bazat e ekonometrisë, që do t'u ndimojnë studentëve të bëjnë hulumtime të veçanta. Përmbajtja: kjo lëndë fokusohet në një spektër të gjerë të metodave të studimit, të cilat mund të shfrytëzohen në kuadër të të gjitha shkencave shoqërore. U kushtohet vëmendje metodave kuantitative dhe atyre kualitative të studimit. Kjo lëndë u kushtohet individëve, të cilët kanë për qëllim të bëjnë studime shoqërore, si pjesë e studimeve të tyre akademike. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Matematika e Biznesit.

• **Kontabiliteti Menaxherial**

Qëllimi i programit është që studentët të fitojnë njohuri të kontabilitetit, të cilat shfrytëzohen nga menaxherët për marrjen e vendimeve. Në mënyrë më specifike, të njihen studentët me konceptet e kontabilitetit për nevojat e menaxherëve dhe me mjetet e nevojshme për marrjen e vendimeve menaxheriale. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e Kontabilitetit.

• **Ekonomia Monetare**

Lënda ka për qëllim të japë njohuri themelore të njëres prej kategorive më dinamike në ekonominë - parave dhe bankave, si një kusht pa të cilin nuk mund të imagjinohet asnjë ekonomi moderne kombëtare. Ajo gjithashtu ka për qëllim të vërë në dukje dhe të përshkruajë trajektore historike të zhvillimit të sistemit bankar, për të sjellë përvojat e vendeve të tjera të zhvilluara në botë dhe të japë njohuri për sistemet e vendeve fqinje si pjesë e mjedisit të tij të drejtpërdrejtë pas diplomimit, i cili do të jetë pjesë e hapësirës së tyre punuese. Kuptimi i operacioneve bankare mundëson besimin më të lehtë të bankierët, ku nevoja për monitorimin e kreditit, apo monitorimin bankar, ose për monitorimin tjetër ofron një mundësi për të tërhequr vëmendjen, ose për të fituar besimin e klientëve, të cilët janë pjesë e procesit të punës së kompanisë, ku ekonomisti i ardhshëm do të punojë. Në anën tjetër sistemi bankar ofron profesion tërheqës dhe prestigjioz se është jo vetëm interesant, por siguron një pozitë dhe status të mirë në shoqëri dhe njëherësh edhe të ardhura të mira. Një pjesë e studentëve të diplomuar mund të orientohen në sektorin bankar, që më tej duke ndjekur kursin, do të mund të gjejnë përgjigje për shumë pyetje lidhur me orientimin e tyre të përafërt profesional. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Hyrje në Biznes dhe Ekonomi, Makroekonomi, Mikroekonomi.

• **Financat e Korporatave**

Qëllimi i lëndës është transferimi i shkathtësive dhe njohurive të nevojshme teorike në fushën e menaxhimit financiar, si dhe përgatitja e studentëve me njohuri dhe me përvojë bashkëkohore teorike në analizën e koncepteve themelore të financave korporative, projekteve investuese financiare e reale dhe vlerësimi i tyre përmes dimensionit kohor të parave. Qëllimi i lëndës vazhdon me trajnimin e studentëve se si t'i përdorin burime adekuate të financimit, si ta bëjnë menaxhimin efikas të kapitalit dhe si ta bëjnë përcaktimin e strukturës adekuate, përcaktimin e politikës adekuate të shpërndarjes së fitimit - politikës së dividendit dhe si të bëhet finalizimi i planifikimit financiar dhe parashikimi, etj. Arritja e objektivave të synuara të lëndës, studentëve u krijon mundësi të reja për qasje më konkurruese në tregun e punës, ose menaxhim më efikas të bizneseve të tyre reale.

• **Menaxhmenti i Investimeve**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri teorike dhe shkathtësi praktike në sferën e investimeve dhe të vendimeve për investime në ndërmarrjet në vend dhe në botën bashkëkohore. E gjithë kjo arrihet përmes një shqyrtimi të veçantë të analizës së investimeve me theks në format dhe motivet e ndryshme të investimeve dhe të procesit të investimeve, të vlerësimit të fizibilitetit të projekteve të investimit deri në vendimin e investimeve të tyre. Gjithashtu ky kurs synon të sjellë metoda moderne për përcaktimin dhe zgjedhjen më të efektshme të projekteve reale të investimeve, që do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve më pozitive financiare; analizën e praktikave bashkëkohore dhe tendencat për kategori delikate të Menaxhmentit ekonomik në investime vitet e fundit dhe proceset investuese. Këto çështje u mundësojnë studentëve qasje më të lehtë për sipërmarrje biznesi, mundësi për të marrë përsipër menaxhmentin e financave në biznesin e tyre familjar, ose qasje më të lehtë të punëdhënësi. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e Menaxhmentit.

• **Financat Publike**

Qëllimet e programit të lëndës: - Studentët të fitojnë njohuri të financave publike, si një mjet i rëndësishëm i politikave makroekonomike, si një instrument themelor për funksionimin e një ekonomie kombëtare, si një tërësi dhe si një nënsistem i një sistemi ekonomik të vendit; - Studentët të fitojnë njohuri për të mirat publike dhe të dalat, eksternalitet, për shpërndarjen e të ardhurave publike, alokimin dhe rialokimin e të ardhurave, të aspekteve krahasuese të financave publike në vendet e zhvilluara dhe atyre në tranzicion, për specifikat e sistemeve fiskale të Maqedonisë së Veriut, tendencat dhe sfidat e tyre, decentralizimit fiskale, etj.; - Studentët të fitojnë njohuri për buxhetin dhe fondet jashtëbuxhetore si instrumente kryesore të politikës fiskale, për procedurat përgatitjes, miratimit, zbatimit dhe kontrollit të buxhetit dhe për teknikat e buxhetit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror; - Te studentët të krijojnë një pasqyrë e qartë lidhur me funksionimin e një sistemi fiskal, në aspektin e teorive të ndryshme fiskale me të cilat mund të bëjnë krahasime të ndryshme dhe për të gjetur pika të përbashkëta të funksionimit të këtyre sistemeve në vende të ndryshme; - Studentët të njoftohen me treguesit kryesorë të politikës fiskale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke krijuar një bazë të dhënash në kuadër të trendeve fiskale afatgjate në RMV, duke inkurajuar studentët që të punojnë seminare të pavarura dhe ese mbi politikën fiskale. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Hyrje në Biznes dhe Ekonomi. Mikroekonomi. Makroekonomi.

• **Ekonomia e Dijes**

Qëllimet e programit të lëndës: - Zhvillimi i një vizioni holistik të gjendjes, tendencat dhe sfidat e ekonomisë së bazuar në njohuri; - Prezantimi i ideve, teorive dhe industrive bazë të ekonomisë së bazuar në dije; - Shqyrtimi i dispozitave kryesore të menaxhimit të njohurive dhe definimi i praktikave dhe teknikave më të mira të menaxhimit të njohurive; - Informacione rreth teknologjive të njohurive të përdorura nga bizneset, si baza të sistemeve efektive të menaxhimit të njohurive; - Demonstrime rreth identifikimeve të proceseve në praktikë, dhe menaxhimi i tyre duke përdorur TI-në; - Specifikimi i kriterëve të formimit dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor; - Analizimi i praktikave më të mira, sfidave dhe mundësive të zbatimit të ekonomisë së bazuar në dije në Maqedoninë e Veriut dhe vende të tjera, duke rishikuar dhe vlerësuar tiparet e zhvillimit modern të ekonomisë së bazuar në dije; - Përgatitja e studentëve për të vepruar në një mjedis të ndërmarrjeve dinamike në kontekstin e menaxhimit të kapitalit intelektual.

Lëndë zgjedhore

• **Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 1**

Programi për Gjuhën Maqedonase për Fillestarë 1, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Përmes ushtrimeve të veçanta dhe ligjëratave u mundësohet studentëve ta njohin komunukimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përhëndetjet, prezantimin, si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara, si dhe detyrave të vazhdueshme përmes, të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive

gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 2, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, plainifikimi i aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi i personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh, që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje.

- **Gjuhë Maqedonase Niveli i Mesëm 1**

Lënda Gjuhë Maqedonase – Niveli i Mesëm 1, përfshinë: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit nëpërmjet të cilit studentët: do të pasurojnë fjalorin përmes teksteve të përshtatshme për aktivitetet e përditshme (në një bankë, në bibliotekë, në ministri, etj.) dhe do të përmirësojnë shkathtësitë për shkrimin profesional dhe të folurit që janë të nevojshem për komunikim të qartë dhe efektiv në karrierën e tyre të mëtejshme profesionale. Një theks i veçantë dhe i vazhdueshëm mbi aktivitetin e përgjithshëm është vendosur në elementet gjuhësorë, domethënë në drejtshkrimin dhe gramatikën e gjuhës standarde maqedonase. Ekspertët, si një nga elementët kyç për shprehjen e mirë me shkrim e përcaktojnë përdorimin korrekt të gjuhës.

- **Gjuhë Maqedonase Niveli i Mesëm 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase – Niveli i Mesëm 2, përfshinë: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit. Theks i veçantë vihet në zhvillimin e aftësive të komunikimit të studentëve, ose përdorimin e gjuhës në aktivitetet e përditshme dhe kontekstin profesional, duke pasuruar fjalorin dhe duke fituar njohuri për strukturën dhe llojet e teksteve profesionale. Do të përfshihen stile të ndryshme të komunikimit, me qëllim që studentët të krijojnë komunikim të mirë me publikun përmes teksteve të tyre dhe të tërheqin dhe mbajnë vëmendjen e tyre.

- **Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 1**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjediseve të ndryshme profesionale. Studentët, pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata, gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përmbushjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturor.

- **Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 2**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata, do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata, gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve.

- **Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë Shqipe për Fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda

(konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë Angleze Niveli Fillestarë**

Pas përfundimit të kësaj lënde studentët pritet të jenë në nivelin A1, sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane dhe të jenë në gjendje t'i kuptojnë dhe t'i përdorin shprehjet e njohura dhe frazat themelore për plotësimin e nevojave dhe kërkesave konkrete; të pyesin dhe të përgjigjen në pyetjet rreth identifikimit dhe marrëdhënieve personale; studentët duhet të jenë në gjendje të prezantojnë veten dhe të tjerët, duke i përdorur përemrat vetor dhe pronor, përsëritjet, emërtimin e gjërave në klasë, ta dallojnë numrin njëjës dhe shumës. Studentët, duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë tipike, të njohin dhe të përdorin struktura të thjeshta gjuhësore për të përshkruar rutinën e tyre të përditshme; të flasin dhe shkruajnë për jetën e tyre, kohën e lirë; të pyesin dhe përgjigjen për ushqimet dhe pijet. Studentët, duhet të jenë në gjendje të dinë datat, ta përdorin në mënyrë të përshtatshme fjalorin e tyre lidhur me muajt e vitit, të bëjnë kërkesa të sjellshme, t'i përshkruajnë vendet, zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime dhe të diskutojnë për preferencat e tyre.

- **Gjuhë Angleze Niveli i Mesëm i Ulët**

Në fund të kësaj lënde studentët pritet të jenë në nivelin A2, sipas Kornizës Evropiane Gjuhësore dhe duhet të jenë në gjendje t'i kuptojnë dhe t'i përdorin saktësisht shprehjet dhe frazat e duhura të një lloji konkret; të pyesin dhe tu përgjigjen pyetjeve në lidhje me identitetin personal, të përshkruajnë vende të ndryshme pune, bisedojnë dhe pyesin për jetën e njerëzve, të përshkruajnë aspektet e punës dhe caktojnë takime. Ata, duhet të jenë në gjendje të flasin për ngjarjet në të kaluarën, të përshkruajnë vendet, udhëtimet dhe historitë personale; zgjedhin një destinacion dhe japin udhëzime; të flasin për aktivitetet e përditshme, për obligimet gjate dites. Ata, duhet të jenë në gjendje të flasin për gjëra dhe punë në shtëpi, të kuptojnë dhe të japin këshilla dhe të shprehin mendimet e tyre; për të diskutuar preferencat e tyre.

- **Gjuhë Angleze Niveli i Mesëm**

Në fund të kësaj lënde studentët pritet të jenë në nivelin B1, sipas Kornizës Evropiane për Gjuhë. Ata, duhet të jenë në gjendje të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve rreth diplomave universitare, shkathtësive dhe situatave të punës; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave. Studentët, duhet të jenë në gjendje të pyesin, ose të përshkruajnë marrëdhëniet familjare dhe statusin martesor dhe duhet të jenë në gjendje të njohin dhe përdorin në mënyrë të përshtatshme fjalorin e lidhur me arsimin e lartë, artin, udhëtimin dhe sportin.

- **Gjuhë Angleze Niveli i Mesëm i Lartë**

Në fund të kësaj lënde studentët pritet të jenë në nivelin B2, sipas Kornizës Evropiane për Gjuhë; pritet që të jenë përdorues të pavarur të gjuhës angleze dhe të zbatojnë disa nga funksionet e mëposhtme gjuhësore: të japin këshilla; të kërkojnë dhe t'u përgjigjen pyetjeve rreth diplomave universitare, aftësive dhe situatave të punës; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë tekste dhe të dëgjojnë me hollësi, me qellim që të kuptojnë idene dhe detajet.

- **Gjuhë Angleze Niveli i Avancuar**

Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, niveli i aftësisë së nxënësve, duhet të jetë në nivelin C1, sipas Kornizës Evropiane për Gjuhë. Si rezultat, studentët, duhet të jenë në gjendje, që me sukses të bëjnë prezantimin me gojë, të marrin pjesë në një forum debati / forum diskutimesh, ku shprehin mendimet dhe argumentet e tyre dhe t'u japin reagime të tjerëve në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët, duhet të jenë në gjendje të dëgjojnë dhe të lexojnë për t'i kuptuar detajet dhe të shkruajnë një paragraf argumentues dhe ese që shprehin mendimin e tyre. Ata, duhet të shkruajnë një paragraf dhe ese për një problem, si dhe zgjidhjen e tij. Studentet, duhet të jenë në gjendje të prezantojnë dhe paraqesin informacione vizuale në një formë të posterave, apo në Power Point.

- **Gjuhë Gjermane**

Me përfundimin e lëndës nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimit të gjuhës. Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët, gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane.

- **Gjuhë Italiane**

Qëllimi i mësimdhënies është që studentët të njihen me kulturën italiane, civilizimin Italian dhe gjuhën italiane. Ideja është që studentët të njohin një realitet tjetër, i cili do t'u ndihmojë në formimin e një ego të vetes, po ashtu edhe në krijimin e një fotografie për veten dhe të ardhmen e tyre. Në përputhje me nivelin (nga A1 deri B2), të cilën studentët do ta zgjedhin, ose nivelet, që do t'i ndjekin në semestrat që i kanë në dispozicion si një lëndë zgjedhore, materia thellohet në mënyre progresive. Në nivelin e parë fillohet me të dhënat bazike, si p.sh: drejtshkrimi, shqiptimi,

terminologjia për menaxhimin me situatat e ndryshme gjuhësore të përditshmërisë (prezantimi i vetes, prezantimi i të tjerëve, orientim në hapësirë dhe kohë, shprehje komunikuese në ndonjë lokal, në restorant, supermarket, në treg), ndërsa arrihet deri në konstruksione më të ndërlikuara në nivelet në vazhdim, që kanë të bëjnë me dhënien e një qëndrimi, dëshire, nevojë, sqarimi të ndodhive të shkuara, të folur të ndodhive të ardhshme, etj. Gramatika prezantohet në mënyrë induktive (nëpërmjet vetëdijesimit nga situatat (audio incizime, video filma, tekste) dhe sjellje të konkluzioneve), në të cilën rolin kryesor e kanë vetë studentët, me pjesëmarrjen e tyre aktive në ligjëratat.

• **Gjuhë Frengje**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i forcojnë bazat dhe aftësitë gjuhësore, si dhe t'i zhvillojnë katër kompetencat e komunikimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme: të jenë në gjendje të shprehin një mendim, • të jenë në gjendje t'i shprehin ndjenjat, • ta kuptojnë thelbin e një shprehjeje, mendimi apo ideje, • të jenë të aftë të argumentojnë dhe mbrojnë mendimin e tyre. • të gjinden në situata të ndryshme, • të mbajnë një fjalim të thjeshtë dhe koherent, • të rrëfejnë një ngjarje, • të rrëfejnë një ëndërr ose përvojë, • të paraqesin arsyet për një projekt ose ide, • të komunikojnë në mënyrë spontane.

• **Liritë dhe të Drejtat e Njeriut**

Qëllimi i lëndës: Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të brendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinës për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë drejtim dhe për mënyrën se si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Lënda do t'i nxisë që të kontribuojnë në përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

• **Teknologjia Reproductive e Asistuar dhe e Drejta**

Qëllimi i lëndës: Kjo lëndë ka për qëllim të theksojë faktin se në shoqërinë bashkëkohore, tanimë nuk ekziston një model universal i familjes dhe prindërisë. Me studimin e lëndës 'Teknologjia reproductive e asistuar dhe e drejta', studentët do të fitojnë njohuri rreth teknologjive të reja për riprodhimin artificial, të cilët janë pjesë e politikës bashkëkohore të natalitetit. Studentët, në detaje do të mësojnë për të gjitha metodat e reja të riprodhimit të qenies njerëzore, duke përfshirë: insimin artificial, in vitro fertilizimi, amësia surrogate, lindja e fëmijës nga një grua me spermë të donuar, riprodhimi post human, ko-prindëria (bashkëprindëria), ngjizja e fëmijës nga tre persona, krioprezervimi i gameteve ose embrioneve. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët do të njoftohen se ekzistojnë edhe forma tjera, të cilat shkenca i ofron, por ende konsiderohen procese të ndaluara: klonimi, zgjedhja e gjinisë së fëmijës, përmirësimi i kapaciteteve fizike, intelektuale të fëmijës së ardhshëm (eugenika), etj. Përmes studimit të kësaj lënde, pritet nga studentët që ta zhvillojnë mendimin e tyre kritik me anë të debateve për dilemat e shumta morale, etike dhe juridike lidhur me këto teknologji të reja për riprodhimin e qenies njerëzore.

• **Komunikimi Ndërkulturor**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët, do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të lëndës, studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

• **Krijimi i Ueb-it**

Qëllimi i lëndës është zhvillimi i një ueb faqe të thjeshtë bazuar në standardet aktuale. Kërkon njohuri të gjuhës Hypertext Markup Language (HTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumica e ueb faqeve përdorin imazhe në formë të banerave, logove, imazheve, ose skanimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e dizajnuara për ueb dhe për të lejuar krijuesit të zgjedhin këto imazhe në mënyrë që të zvogëlojnë madhësinë e skedarit. Fireworks gjithashtu mundëson integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo lëndë ofron një seri aktivitete që mundësojnë një hyrje gjithëpërfshirëse në HTML, CSS dhe krijimin e imazheve për ueb.

- **Dizajnimi i Mediemeve Digjitale**

Qëllimi i lëndës është të dizajnojë dhe përpunojë grafika raster dhe vektoriale përmes programeve kryesore, siç janë Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe projektimin dhe botimin e materialeve komerciale për shtyp, duke përdorur Adobe In Design.

- **Shkathtësi të TI për Produktivitetin e Zyrës**

Ky program krijon shkathtësitë që i ndihmojnë studentët ta përmirësojnë produktivitetin e tyre në klasë dhe TI karrierë. Programi ofron një gamë të gjerë të moduleve që përfshijnë: BAZAT KOMPJUTERIKE - shkathtësitë dhe konceptet që lidhen me përdorimin e pajisjeve, krijimin dhe menaxhimin e skedarëve, rrjetet dhe sigurinë e të dhënave. BAZAT E PUNIMIT ONLINE - shkathtësitë dhe konceptet që lidhen me ueb shfletuesit, kërkimin efektiv të informacionit, komunikimin online dhe me e-mail. PËRPUNIMI I TEKSTIT - shkathtësi për të kryer detyrat e përditshme që lidhen me krijimin, formatimin dhe përfundimin e dokumenteve të përpunimit të tekstit, siç janë letrat, CV-të dhe dokumente të tjera. PROGRAMI PËR TABELIM - shkathtësi për të kryer detyra që lidhen me zhvillimin, formatimin, modifikimin dhe përdorimin e një programi për tabelim (spreadsheet), përdorimin e formulave dhe funksioneve standarde dhe për të krijuar kompetenca dhe formatimin e grafikëve, ose tabelave. PREZANTIMET - shkathtësi për të krijuar prezantime standarde profesionale. Për të kryer detyra të tilla si krijimin, formatimin, modifikimin dhe përgatitjen e prezantimeve duke përdorur skeda të formave të ndryshme për prezantim elektronik dhe materiale të shtypura. PËRDORIMI BAZAVE TË TË DHËNAVE - shkathtësi për të përdorur bazat e dhënave në mënyrë efektive. Kuptim të koncepteve kryesore të bazave të të dhënave dhe demonstrim të aftësive për të përdorur aplikacionet e bazave të dhënave: krijimin dhe modifikimin e tabelave, pyetësorëve, formularëve dhe raporteve, si dhe përgatitjen e rezultateve të gatshme për shpërndarje. Të mësuarit për të lidhur tabelat dhe për të rifituar dhe manipuluar informacionin nga një bazë të dhënash duke përdorur mjetet e pyetësorëve dhe të renditjes.

- **Microsoft Office Access**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Aksesin 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 15 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-730.

- **Microsoft Office Excel**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Excel 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 13 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-727.

- **Microsoft Office PowerPoint**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për PowerPoint 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-729.

- **Microsoft Office Word**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Word 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-725.

- **Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor**

Qëllimi i lëndës: Qëllimi i lëndës është që të ofrojë njohuritë themelore të shkrimit dhe arsyetimit juridik studentëve të drejtësisë dhe të kriminalistikës të vitit të parë. Në këtë lëndë, do të përfitohen njohuritë e shkrimit dhe arsyetimit juridik, parimet dhe udhëzimet themelore për të, duke zbatuar metodat e ndryshme të shkrimit juridik të akteve juridike normative (rregulloret, ligjet, vendimet, aktgjykimet, kontratat, testamentet, etj) dhe të akteve juridike jonormative (CV, kërkesa, konkursi, aplikimi, njoftimi, padia, etj). Për studentët e drejtësisë, kjo lëndë është më se e nevojshme që të përfitojnë shkathtësitë e shkrimit të duhur juridik, si dhe të arsyetimit të duhur të asaj që e shkruajnë juridikisht, sepse mjeshtria e të shkruarit juridik është thelbësore për çdo jurist në punën e tij të ardhshme profesionale.

- **E Drejta e Teknologjisë së Informacionit**

Qëllimi i lëndës: Qëllimi kryesor është që studentët të njihen me mundësitë e aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në profesionin juridik. Studentët, do të njoftohen me bazat e përgjithshme konceptuale të informatikës juridike. Theks i veçantë është vënë në fitimin e aftësive, përkatësisht njohurive praktike në gjetjen dhe përdorimin e informacioneve juridike me ndihmën e teknologjive të reja, bazave të të dhënave dhe mjeteve të kërkimit. Studentët, gjithashtu do të njihen edhe me çështjet themelore të e-qeverisjes, e-tregtisë, e-prokurimit, e-drejtësisë dhe e-demokracisë.

- **Zhvillimi Profesional i Karrierës**

Lënda është e dizajnuar që të zhvillojë dhe përmirësojë aftësitë dhe shkathtësitë e studentëve për të kërkuar punë si dhe të kenë sukses në vendin e tyre të punës. Kjo lëndë përfshin një pako të materialeve, ushtrimeve praktike dhe përvojë të personave nga praktika me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të studentëve për tregun e punës, e cila është gjithnjë e më shumë konkurrense. Lënda ka për qëllim t'i aftësojë studentët në përpilimin cilësor të CV-së, letrës së motivimit dhe përgatitjes së tyre për intervistë. Fushat shtesë, që trajtohen në këtë lëndë janë: vetëvlerësimi, analiza e vendit të punës, përshkrimi i vendit të punës etj. Kështuqë studentët në përfundim të lëndës pajisen me një portofol dokumentesh, të cilët do t'iu duhen për të aplikuar për punë dhe për të pasur avantazh konkurrues në tregun e punës.

- **Terminologjia Administrative dhe Nomoteknika**

Në këtë lëndë, studentët do të fitojnë njohuri themelore në lidhje me disiplinën shkencore të terminologjisë administrative dhe nomoteknikën, gjegjësisht teknikat e krijimit të projekt-akteve të legjislacionit kombëtar. Gjithashtu, studentët do të mësojnë teknikat e krijimit të legjislacionit ndërkombëtar, procedurat për miratimin e akteve ligjore (ligjet, aktet nënligjore) etj.

- **Zhvillimi i Shkathtësive Sociale**

Në këtë lëndë, studentët do të fitojnë aftësi individuale dhe ndërpersonale, do të krijojnë marrëdhënie pozitive me të tjerët përmes kuptimit të emocioneve, shpërndarje të dallimeve, zgjidhjes së konflikteve, dhënies ose marrjes së informatave kthyesë në mënyrë konstruktive. Ata bashkëveprojnë me sukses për të arritur konsensus nga palët e interesuara dhe vendimmarrësit dhe nxisin klimë pozitive të komunikimit brenda mjedisit sfidues të vendit të punës. Me anë të kësaj lënde ata rriten në krye të efektivitetit të tyre personal, ndihmojnë në zvogëlimin e kostos së rimëkëmbjes dhe të kostove të trajnimit dhe në mënyrë të konsiderueshme kontribuojnë në rritjen organizative.

- **Strategjitë për Kërkim të Karrierës**

Lënda është dizajnuar që t'u sjellë beneficione të gjithë studentëve, qoftë atyre që janë në procesin e kërkimit aktiv të punës, qoftë atyre që tanimë janë të punësuar. Lënda u ndihmon shumë studentëve në lidhje me kalimin e tyre nga një mjedis akademik në një realitet të punës, ku do të krijohet karriera e tyre. Ky kalim sjell ndryshime, e ndryshimet sjellin shumë pyetje për të panjohurën që zbulohet. Shpesh këto të panjohura lidhen me mundësitë, rrogën fillestare, potencialin për të fituar, rrezikun, sigurinë, lokacionin, trajnimin, konsideratat për stilin e të jetuarit, etj. Planifikimi i karrierës i ngjan një "rrote" me katër mbajtëse, e cila rrotullohet vazhdimisht dhe gjatë lëvizjes mbledh informata të reja lidhur me karrierën. Informatat e mbledhura përfshijnë të dhëna, të cilat ju ndihmojnë të gjeni përgjigje për pyetjet e juaja dhe ua lehtëson kalimin e sipërpërmendur.

- **Kapituj të Zgjedhur në Kompjuteristikë**

Kjo lëndë paraqet një hyrje të gjerë dhe të integruar në konceptet themelore të shkencave kompjuterike. Lënda mbulon tema, siç janë: historia e llogaritjes; logjika dhe sistemet digjitale; hyrje në arkitekturën kompjuterike, algoritme të thjeshta, zgjidhje problemesh dhe struktura të të dhënave; hyrje në gjuhët e programimit, sistemet operative, bazat e të dhënave, rrjetat, inxhinieria e softuerit dhe ueb-it; llojet e aplikacioneve, përfshirë edhe përshkrimin e disa programeve specifike (procesorë teksti, baza të dhënash, shfletues, etj.); procedimi i të dhënave tradicionale dhe multimediale.

- **Ueb-Teknologjitë**

Qëllimi kryesor i lëndës është që t'u japë studentëve njohuri praktike mbi mekanizmat themelore, shërbimet dhe protokollet e rrjetit global - Internetit. Lënda ofron mësimin e arkitekturës së përgjithshme të ueb faqeve efikase, bile dhe të sigurta. Studentët, do të fitojnë njohuri të thella teknike HTML-se (listat, tabelat, figurat, elementet multimediale dhe formularët), CSS (formatimi, stilet dhe layout-i), si dhe JavaScript (variablat, kushtet, ciklet dhe funksionet), të rëndësishme në krijimin e ueb faqeve.

- **Të Shkruarit Akademik në Gjuhën Angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët, do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjesë të shkruar, do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Të Shkruarit Akademik në Gjuhën shqipe**

Në fund të çdo niveli, studentët do të jenë në gjendje të shkruajnë ese dhe punime kërkimore bazuar në rregullat e mësuara gjatë ligjëratave. Më konkretisht, nga studentët pritet që t'i mësojnë funksionin, strukturën dhe llojet e

ndryshme të paragrafëve, mënyrat se si të zgjedhin tema për punime kërkimore, si të grumbullojnë materiale, rregullat se si t'i dokumentojnë referencat e të arrijnë deri tek modeli përfundimtar.

- **Të Shkruarit Akademik në Gjuhën Maqedonase**

Pas mbarimit të kësaj lënde, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të përshtatshme dhe komunikim të avancuar në gjuhën maqedonase me theks të veçantë në aftësitë e të shkruarit. Pos kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm. Për më tepër, studentët do të jenë në gjendje t'i përmirësojnë aftësitë e tyre të të shkruarit në më shumë nivele dhe në këtë mënyrë, do të bëhen më të sigurt dhe më kompetentë gjatë të shkruarit në gjuhën maqedonase. Studentët, do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin konkludime. Studentët, gjithashtu, do të zhvillojnë aftësi për shkrim dhe komunikim të shkëlqyer në gjuhën maqedonase.

- **Gjuhë Shqipe për Qëllime Specifike**

Lënda ka për qëllim përmirësimin dhe përsosjen e të shprehurit në gjuhën shqipe, qoftë me gojë ose me shkrim. Në mënyrë të veçantë lënda ka për qëllim t'i njoftojë studentët me terminologjinë specifike, mundësitë e përdorimit të saj, me përmirësimin e gabimeve më të shpeshta në të folurit e përditshëm, por edhe për komunikim të drejtë në rrethana specifike. Studentët, do të njoftohen me kushtet në të cilat ata rregulla hyjnë në përdorim, në mënyrë që të njëjtat të mund t'i përdorin jo vetëm për detyrat në lidhje me këtë temë, por edhe në karrierën e tyre të ardhshme profesionale.

- **Gramatika e Gjuhës Angleze në Praktikë**

Lënda është kryesisht i destinuar për studentët e nivelit të mesëm dhe të mesëm të lartë, studentët që kanë studiuar tashmë gramatikën bazë të gjuhës angleze. Ajo përqendrohet në ato struktura që studentët e emëruar duan t'i përdorin, por që shpesh u shkaktojnë vështirësi. Kursi në fjalë mund të shërbejë si bazë për përsëritje dhe si mjet për ushtrimin e strukturave të reja. Ndërsa studentët presin dhe kanë nevojë të mësojnë rregullat formale të një gjuhe, është e rëndësishme që ata të praktikojnë struktura të reja në kontekste të ndryshme në mënyrë që të internacionalizohen dhe të përvetësohen. Për këtë qëllim, kjo lëndë ofron një numër të mjaftueshëm të ushtrimeve të kontrolluara dhe komunikative, në mënyrë që studentët të mund të lidhin hendekun midis njohjes së strukturave gramatikore dhe përdorimit të tyre.

- **Gjuhë Angleze për Bashkëbisedim**

Gjuhë Angleze për Bashkëbisedim është lëndë një-semestrale e hartuar për folësit e gjuhës angleze të nivelit të mesëm dhe më lart. Lënda, do të jetë në dispozicion për studentët në të gjitha semestrat. Anglishtja është një gjuhë ndërkombëtare, që e lehtëson komunikimin në kontekste të ndryshme në mbarë botën, duke filluar nga takimet e biznesit dhe transaksionet në bisedat e rastësishme midis miqve dhe ndërveprimeve gjatë udhëtimit. Anglishtja, në bisedë, do të ndërtojë aftësitë e të dëgjuarit dhe të folurit e studenteve, duke ofruar gramatikë, fjalorin, shqiptimin dhe praktikën e rrjedhshmërisë së nevojshme për llojet e zakonshme të ndërveprimeve të folura angleze. Ky kurs, do të mbulojë tema që lidhen me bisedën profesionale, bisedat e rastësishme dhe ndërveprimet e përditshme, duke u siguruar studentëve besimin e bisedave në një kontekst të ndryshëm. Biseda profesionale, do të përfshijë lloje formale dhe të sjellshme të fjalimit të përdorura në kontekste të tilla, si takime pune, ose diskutime me kolegët. Biseda e rastësishme, do të përfshijë praktikën me gjuhën e përdorur gjatë shoqërimit me miqtë, ose familjen dhe situata të tjera joformale dhe do të përfshijë zhargon dhe fjalim joformal. Ndërveprimet e përditshme, do të përfshijnë biseda në dyqane, gjatë udhëtimit dhe duke kërkuar ndihmë. Metodat e të mësuarit, do të fokusohen në praktikë dhe do të përfshijnë aktivitete dëgjimi, dialogë, role , simulime, debate dhe diskutime.

- **Arsimim Online dhe Digjital**

Lënda Arsimimi Online dhe Digjital, është lëndë një-semestrale me 3 orë në javë, e cila ofrohet në studimet deridiplomike. Lënda është e përpiluar në bazë të nevojave të studentëve dhe në vete ngërthen shkathtësi të ndryshme të shekullit 21, të cilat janë të lidhura me përdorimin efektiv të teknologjisë. Lënda përmban tri kategori të shkathtësive të shek 21. Pas mbarimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të kenë qasje në informatat online, duke përdorur vegla të ndryshme digjitale, të vlerësojnë në mënyrë kritike vërtetësinë e materialeve online dhe të bëjnë dallim mes burimeve të vërteta dhe të rrejshme, të tregojnë mirëkuptim për problemet etike në kontekstin akademik, të kuptojnë si përdoren citatet në mënyrë të drejtë, të mësojnë si kryhet komunikimi profesional në mënyrë efikase, t'i kuptojnë gjërat bazike të sigurisë në internet, si dhe aspektet pozitive dhe negative të krijimit të identitetit online, ta hetojnë shqetësimin-sajber dhe t'i identifikojnë zgjedhjet e mundëshme për zvogëlimin e online shqetësimeve.

- **Mbrojtja e Konsumatorëve**

Qëllimi i lëndës: Qëllimi kryesor është që studentët të njihen me kuptimin, burimet, marrëdhëniet me degët e tjera të së drejtës, subjektet (personat fizik dhe juridik), institucionet ligjore për mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtja përmes zbatimit të përgjegjësisë për shkak të defekteve fizike në artikull, mbrojtja e mangësive ligjore në artikull, mbrojtja e

funksionimit normal saldimi, nëpërmjet përdorimit të rrjeteve administrative nga organet administrative, mbrojtja nga vendosja e standardeve, mbrojtja përmes masave ligjore, si dhe me procedurat e mbrojtjes së konsumatorit.

- **E Drejta Tregtare**

Qëllimi i lëndës: Qëllimi kryesor është që studentët të njihen me subjektet e së drejtës tregtare (tregtari, tregtari individual, shoqëritë tregtare), lidhja e shoqërive tregtare, ndërprerja e shoqërive tregtare (likuidimi dhe falimentimi), marrëveshjet tregtare, të drejtat e pronësisë industriale, letrat me vlerë.

- **Dhuna në Familje**

Qëllimi i lëndës: Dhuna në familje është një fenomen shoqëror me përmasa dhe shtrirje të gjerë edhe në shoqërinë bashkëkohore. Ajo është e pranishme në të gjitha shtetet e shoqëritë pavarësisht zhvillimit dhe emancipimit të tyre. Imune ndaj këtij fenomeni nuk është as vendi ynë e as rajoni në të cilin jetojmë. Andaj, studentët e drejtësisë përmes kësaj lënde fitojnë njohuri rreth asaj se çfarë është dhuna në familje, format në të cilat ajo manifestohet, rregullimet ligjore në vend, rajon dhe në sferën ndërkombëtare, si dhe mënyrat e parandalimit të saj. Përmes kësaj lënde, studentët në fund të lëndës, do të jenë në gjendje ta identifikojnë dhunën në familje, t'i identifikojnë veprat penale që inkriminohen në Kodin Penal si dhunë në familje, si dhe të zhvillojnë mendim kritik rreth kësaj problematike. Kjo lëndë e aftëson juristin e ardhshëm që gjatë ushtrimit të profesionit të tij si gjykatës, prokuror apo avokat t'i trajtojë në mënyrë sa më adekuate çështjet nga kjo sferë që kanë ndjeshmëri të lartë, si dhe të ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje sa më adekuate për viktimat e këtyre veprave penale.

- **Siguria Kompjuterike**

Qëllimi i lëndës: Siguria kompjuterike, do të eksplorojë elementët më të rëndësishëm që e formësojnë fushën e lëndës në të cilën shfaqen dhe menaxhohen problemet e sigurisë kibernetike. Lënda, do të theksojë se si kornizat etike, ligjore dhe ekonomike mundësojnë dhe kufizojnë teknologjitë dhe politikat e sigurisë. Ajo do të prezantojë disa prej makro-elementeve më të rëndësishme (siç janë konsideratat e sigurisë kombëtare dhe interesat e shteteve-nacionale) si dhe mikro-elementet (siç janë njohuritë e sjelljes në mënyrën se si njerëzit i kuptojnë dhe bashkëveprojnë me tiparet e sigurisë). Temat specifike përfshijnë hartimin e politikave (në nivel kombëtar, ndërkombëtar dhe organizativ), kornizat ligjore (duke përfshirë detyrat e sigurisë, çështjet e privatësisë, çështjet e qasjes në zbatimin e ligjit, sulmet në kompjuter dhe spiunazhin ekonomik/ushtarak), rolet e përdoruesve, qeverisë dhe industrisë.

- **Mediat Sociale dhe e Drejta**

Qëllimi i lëndës: Deri në fund të semestrit, studentët në këtë kurs do të jenë në gjendje të: identifikojnë të drejtat e tyre individuale, atyre që i referohen në mënyrë specifike mediave sociale dhe më gjerë; të përshkruajnë mënyrat në të cilat teknologjitë e reja të komunikimit po zhvillohen dhe vazhdojnë të ndikojnë në rendin tonë juridik dhe atë botëror; të krijojnë një pasqyrë se si mediat sociale, televizioni, interneti dhe teknologjitë e tjera të komunikimit ndikojnë në kuptimin e tyre të ligjit dhe të drejtësisë; klasifikimi i çështjeve ligjore që kompanitë e industrive të ndryshme mund të përballen kur integrojnë mediat sociale në praktikën e tyre të biznesit; të njohin pasojat potenciale pozitive dhe negative të prezencës së tyre personale në media.

- **Komunikimi Afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me konceptet e komunikimit të biznesit. Kjo lëndë është një përpjekje për të përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me tregues teorikë dhe para së gjithash me demonstrime praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në një mjedis organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe mbajtjes së takimeve, intervistimin, se si të përgjigjen gjatë intervistës, negociimit dhe motivimit i të gjithëve në rrethin tyre.

- **Lidershipi dhe Zhvillimi Organizativ**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me mënyrën se si liderët dhe udhëheqësit i zhvillojnë dhe si i zbatojnë arritjet e misionit dhe vizionit në një organizatë të dhënë në sektorin publik; zhvillimin e vlerave të nevojshme për sukses afatgjatë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shprehive të përshtatshme; si liderët dhe udhëheqësit janë personalisht të përfshirë në sigurimin, që sistemet e menaxhimit të sigurisë, do të zhvillohen dhe zbatohen. Gjithashtu i njofton për mënyrën se si organizata e realizon misionin dhe vizionin e saj përmes një strategjie të qartë të bazuar në pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, të mbështetur nga të gjitha politikat relevante, planet, qëllimet dhe proceset.

- **Aftësitë e Komunikimit**

Lënda është dizajnuar t'u mundësojë studentëve që praktikisht ta zbatojnë komunikimin ndërpersonal. Studentët, do të mësojnë aftësi ndërpersonale, siç janë: perceptimi, të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe ai jo verbal; do ta ushtrojnë të folurit publik, si për shembull: organizimin, prezantimin dhe bazat e të shkruarit fjalime publike. Studentët do të

kenë mundësinë të praktikojnë komunikimin në grupe të vogla, duke filluar nga: lidershipi, vetëbesimi dhe të dëgjuarit. Lënda, po ashtu ofron njohuri themelore të nevojshme për ta kuptuar procesin e kërkimit të një vendi pune nëpërmjet komunikimit me shkrim dhe me gojë, duke shkruar rezyme, letër motivimi dhe duke simuluar intervista.

- **Zhvillimi i të Menduarit Kritik**

Studentët identifikojnë dhe përdorin aftësitë, proceset dhe teknikat e të menduarit kritik që do t'i ndihmojnë ata në karrierën e tyre dhe në jetën personale. Studentët i zhvillojnë aftësitë e tyre për të hetuar dhe vlerësuar mendimin nga këndvështrime të ndryshme dhe për të sintetizuar pozicionet e tyre në bazë të dëshmimeve në dispozicion. Gjithashtu, studentët praktikojnë teknika që u mundësojnë atyre të maksimalizojnë rezultatet që krijojnë gjatë çdo përvoje të tyre afatgjate të të nxënies, duke identifikuar, analizuar dhe formuluar zgjidhjet për problemet, kur ato paraqiten. Ata do të zhvillojnë strategji të të menduarit kritik dhe do t'i zbatojnë ato në lexim, shkrim dhe dëgjim. Studentët, do të zbatojnë strategjitë e pyetjeve, do të angazhohen në të menduarit reflektues, në zgjidhjen e problemeve dhe në testimin e argumenteve.

- **Marrëdhëniet me Publikun dhe Mediat e Reja**

Lënda, do të fokusohet në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të teknikave që janë të domosdoshme për funksionimin efektiv në epokën e globalizimit. Studentët, do të përpunojnë procesin e globalizimit, aspektet sociale, aspektet politike, ekonomike dhe kulturore të fenomenit modern, si dhe pasojat dhe ndikimet në sferën e komunikimit, të cilat njëherësh karakterizuan edhe një epokë të postmodernizmit, veçanërisht ndikimin e mediave të reja sociale, strukturën dhe funksionin e tyre, multilingualizmin në rrjetet sociale, efektet dhe pasojat në realitetet moderne të komunikimit në botë.

- **Anglishtja e Biznesit 1**

Studentët, do të njohohen me elemente gjuhësore të nevojshme për t'i kuptuar dhe përpunuar parimet dhe konceptet e përdorura gjatë komunikimit në ambient biznesor/afarist. Me përfundimin e suksesshëm të kësaj lënde, studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit dhe të të folurit në publik, do të jenë në gjendje të përdorin argumente për mbështetjen e qëndrimeve, por edhe t'i respektojnë mendimet e të tjerëve, si dhe do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit afarist bashkë me aftësitë për gjetje të punës në të ardhmen.

- **Anglishtja e Biznesit 2**

Studentët, do të njohohen me elemente gjuhësore të nevojshme për t'i kuptuar dhe përpunuar parimet dhe konceptet e përdorura gjatë komunikimit në ambient biznesor/afarist. Me përfundimin e suksesshëm të kësaj lënde, studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit dhe të të folurit në publik, do të jenë në gjendje të përdorin argumente për mbështetjen e qëndrimeve, por edhe t'i respektojnë mendimet e të tjerëve, si dhe do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit afarist bashkë me aftësitë për gjetje të punës në të ardhmen.

- **Hyrje në Ekonomi dhe Biznes**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është ta zhvillojë kuptimin bazik të koncepteve dhe teorive kryesore ekonomike, të cilat përdoren për analizë të çështjeve ekonomike. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë formë që t'u mundësojë studentëve të pajisen me njohuri për parimet bazë, me konceptet dhe teknikat në fushën e ekonomisë si shkencë, si dhe në analizat ekonomike. Kjo lëndë siguron hulumtimin e parimeve të mikroekonomisë dhe makroekonomisë, duke u fokusuar në implementimin e dijes dhe në sjelljen e vendimeve në një ambient global. Pas mbarimit të lëndës, studentët duhet të aftësohen: ta përdorin modelin e ofertës dhe kërkesës dhe ta përcaktojnë ndikimin e ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës mbi çmimin dhe sasinë; ta definojnë PBB (GDP) dhe të kalkulojnë matjen, përdorimin dhe kufizimin e PBB (GDP), si një mjet i mirëqenies ekonomike; ta definojnë inflacionin dhe ta kalkulojnë atë, të njihen me pasojat dhe si të përshtaten në to; si dhe t'i përshkruajnë rolet dhe mjetet e bankës qendrore.

- **Marketing Menaxhment**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të përgatiten për t'i përdorur dhe t'i menaxhuar 4 P-të në një organizatë, ose kompani, ashtu që të jenë në gjendje t'i dizajnojnë elementet optimale të marketingut, produktin, çmimet, promocionin dhe metodat e shpërndarjes me të cilat ballafaqohen kompanitë. Në mënyrë më specifike, qëllimi është të kuptohet kompleksiteti i vendimeve në menaxhimin e marketingut, si dhe kornizat për analizat e tregjeve, klientëve, konkurrentëve, si dhe integrimi i koncepteve me planin origjinal të marketingut. Parakusht për ta regjistruar këtë lëndë: Parimet e Marketingut.

- **Menaxhmenti Strategjik**

Qëllimi i kësaj lënde është: vlerësimi dhe zbatimi i elementeve kyçe të analizës strategjike, duke zgjedhur strategjinë e duhur brenda një plani fleksibël, pastaj ta stimulojë të menduarit strategjik në lidhje me problemet që kanë të bëjnë me zbatimin e strategjisë së formuluar. Po ashtu, qëllimi i lëndës është që studentët të mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike rreth çështjeve dhe problemeve, që lidhen me zgjedhjen e strategjisë në mjedisin e trazuar dhe dinamik, si dhe të kuptojnë se nuk ka ndonjë mënyrë të vetme të drejtë për të zhvilluar strategji. Pas përfundimit të ligjeratave, studentët, duhet të jenë në gjendje: t'i kuptojnë teoritë dhe konceptet e menaxhmentit strategjik, ta përvetësojnë fjalorin lidhur me menaxhmentin strategjik, t'i integrojnë njohuritë e fituara në funksionet e veçanta menaxheriale, t'i zhvillojnë aftësitë analitike dhe të komunikimit, si dhe aftësi për punë ekipore. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e Menaxhmentit.

- **Financat Kuantitative**

Kjo lëndë siguron teknika ekonometrike, të tilla si analiza e serive kohore, të nevojshme për të analizuar çështjet teorike dhe empirike në financa. Po ashtu, siguron aplikime në çmimet e pronës (aseteve), në investimet, analizën dhe menaxhimin e rrezikut, mikrostrukturën e tregut dhe në parashikimin e kthimit.

- **Menaxhmenti Financiar**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri dhe aftësi në fushën e menaxhmentit financiar, si dhe të pajisen me dije bashkëkohore teorike dhe me përvoja të analizës së koncepteve themelore të financave për korporatat, të përgatiten për projekte financiare dhe reale të investimit dhe për vlerësimin e tyre përmes dimensionit kohor të parasë. Qëllimi i lëndës vazhdon me aftësimin e studentëve se si të përdorin burime adekuate të financimit, si ta bëjnë menaxhmentin e kapitalit dhe përcaktimin e strukturës së duhur në mënyrë efektive, pastaj përcaktimin e politikave të përshtatshme të shpërndarjes së fitimit dhe dividendës, politikën e planifikimit financiar dhe parashikimin. Arritja e qëllimeve të përcaktuara të lëndës, studentëve u krijon mundësi të reja për qasje konkurruese në tregun e punës, ose i aftëson që në mënyrë më efektive të bëjnë menaxhmentin e bizneseve të veta reale.

- **Paraja dhe Banka**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i japë njohuritë themelore për një ndër kategoritë më dinamike të ekonomisë - paratë dhe bankat pa të cilat nuk mund të paramendohet asnjë ekonomi. Gjithashtu, qëllimi është që të paraqitet dhe të përshkruhet linja historike e zhvillimit të bankave, studentët të njihen me përvojat e vendeve më të zhvilluara nga bota dhe të paraqiten sistemet e shteteve fqinje. Të kuptuarit e sistemit bankar mundëson krijimin e besimit më të madh ndaj bankave, u mundëson studentëve ta mësojnë procesin e punës. Nga ana tjetër sistemi bankar paraqitet si fushë atraktive dhe prestigjioze, e cila jo vetëm që siguron pozicion me status në shoqëri, por mundëson edhe përfitime të mëdha. Studentëve, të cilët do të vendosin të punësohen në banka, kjo lëndë do t'u mundësojë që ata të njihen më së afërmi me sistemin bankar. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Makroekonomia, Mikroekonomia.

- **Ekonomia Ndërkombëtare**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të aftësohen ta kuptojnë dallimin në mes të krijimit global, mirëmbajtjen dhe modifikimin në krahasim me strategjitë ndërkombëtare në aspektin e biznesit ndërkombëtar; të fitojnë njohuri për të kryer analizë për shpenzimet nga një perspektivë globale; të fitojnë njohuri për të kryer analizat SWOT për kompani të ndryshme ndërkombëtare, si dhe të jenë në gjendje të mësojnë tregje të reja globale. Ata duhet ta kuptojnë thelbin e biznesit global ndërkombëtar dhe shfrytëzimin e komunikimit global; t'i përcaktojnë dhe të përdorin strategji për vlerësimin e sipërmarrjes të përbashkët (joint venture), për të bashkuar dhe blerjen e kompanive të ndryshme në mënyrë që të kenë akses në tregjet e reja. Po ashtu, duhet të dinë të marrin vendime për segmentimin e tregjeve, si dhe mënyrat për të hyrë në këto tregje.

- **Ekonomia e Investimeve**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të marrin dije teorike dhe praktike nga sfera e investimeve dhe proceseve bashkëkohore të investimit, si në planin mikro, ashtu edhe në atë makro. Gjithashtu, studentët duhet të trajnohen nëpërmjet analizave të investimeve si kategori ekonomike, t'i mësojnë motivet dhe funksionet e investimeve me theks të veçantë në ndikimin e investimeve në zhvillimin ekonomik të një ekonomie nacionale. Më tutje, në këtë lëndë studentët do të njihen me metodat më bashkëkohore të selektimit të investimeve financiare në arritjen e profitabilitetit më të madh. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Makroekonomia, Mikroekonomia.

- **Komunikimi Afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me konceptet e komunikimit të biznesit. Kjo lëndë është një përpjekje për t'i përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me tregues teorikë dhe para së gjithash me demonstrime praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në një mjedis organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe mbajtjes së takimeve, intervistimin, si të përgjigjen gjatë intervistës, negocimi dhe motivimi i të gjithëve në rrethin tyre.

- **Menaxhmenti i Burimeve Njerëzore**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me rolin dhe rëndësinë e menaxhmentit të burimeve njerëzore në organizatat bashkëkohore të biznesit. Në kuadër të kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri lidhur me menaxhmentin e procesit të burimeve njerëzore, si në teorinë ashtu edhe në praktikën e kompanive ndërkombëtare dhe vendore. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimi i Menaxhmentit.

- **Etika Afariste**

Pas mësimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje: - Të shpjegojnë se si etika i ndihmon menaxherët ta përcaktojnë mënyrën e duhur lidhur me grupe të ndryshme të interesuara për organizimin e tyre; - Ta përshkruajnë konceptin e përgjegjësisë shoqërore dhe t'i precizojnë mënyrat në të cilat organizatat mund t'i nxisin punonjësit të sillen në mënyrë etike dhe të sillen me përgjegjësi; - Ta përcaktojnë diversitetin dhe të shpjegojnë pse menaxhmenti efektiv i përbërjes së ndryshme të të punësuarve është një çështje etike dhe një mjet përmes së cilit organizata do ta përmirësojë punën e saj.

- **Ekonomia e Integrimi Evropiane**

Objektivat e këtij programi janë që të sigurojë hyrje në ekonominë e proceseve të integrimi evropiane dhe të sqarohet pse është me rëndësi të përvetësohen integrimet evropiane, veçanërisht të bëhet dallimi midis integrimi ekonomike ndërkombëtare dhe rajonale. Lënda gjithashtu i udhëzon studentët për llojet e ndryshme të integritit rajonal dhe ndërkombëtar, ku vepron dhe funksionon BE-ja në periudha të ndryshme. Përveç kësaj, programi i lëndës flet për Bashkimin Monetar Evropian, për konceptet e bilancit të pagesave dhe kontabilitetit. Në kuadër të lëndës jepet një pasqyrë e qeverisjes korporative në BE, struktura e qeverisjes korporative në masë të madhe ndryshon nga vendi në vend, si reflektim i sistemeve të ndryshme kulturore, ekonomike, politike dhe juridike.

- **Financat Lokale**

Të jepet një bazë për sistemin e financave lokale qeveritare si një tërësi dhe për financimin e shërbimeve individuale. Të kuptohen sfidat dhe të sigurohen plane për të ndërmarrë veprime në lidhje me mundësitë dhe rreziqet e pranishme në sistemin e financave qeveritare lokale.

- **Menaxhmenti i Sigurimeve**

Përmes kësaj lënde jepet kuptimi themelor për menaxhmentin e sigurimit. Studentët i përpunojnë aspektet teorike dhe i fitojnë shkathësitë dhe dituritë e nevojshme në sferën e menaxhmentit të sigurimit. Në kuadër të kësaj lënde janë përfshirë shkathtësitë themelore, që përdoren në organizatat moderne, të cilat janë të lidhura me logjikën e proceseve të sigurimeve, planifikimit financiar, elementeve të sigurimeve, llojeve të sigurimeve, etj. Vlerësimi është shkathësi, e cila nevojitet për të gjithë menaxherët dhe për të gjitha disiplinat. Prandaj kujdes i veçantë i kushtohet drejtimit të mjeteve të qeverisjes, qeverisjes me riskun nga sigurimi, shfrytëzimi i teorisë dhe modeleve të gjasës për drejtimin efikas me rrethimin e veçantë të shoqatave të sigurimeve, etj.

- **Tregu i Punës**

Qëllimi kryesor i lëndës Tregu i punës është t'i pajisë studentët me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë së tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda Tregu i Punës, ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale, të cilët mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve, që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj, studenti për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme, që lidhen me tregun e punës.

- **Modelimi financiar**

Qëllimet e lëndës: - Zhvillimi i karrierës në fondet investuese për hulumtim, investimet bankare, rejtingu i kredive, projekti i financave, analiza e biznesit; - Hyrje në excel modelimit për analizimin, vlerësimin e kompanive të ndryshme

dhe parashikimet; - Përgatitja e hulumtimeve financiare, pasqyrë dhe vlerësim për sektorë të ndryshëm.

- **Sistemi Fiskal dhe Monetar në BE**

Studimi i kësaj lënde duhet t'u mundësojë studentëve të njihen me çështjet që kanë të bëjnë me harmonizimin e sistemeve tatimore të vendeve anëtare, si dhe me strukturën dhe funksionimin e sistemit monetar evropian. Në këtë kuptim, në kuadër të kësaj lënde vëmendje e veçantë do t'u kushtohet çështjeve të mëposhtme të rëndësishme: sistemeve tatimore të vendeve të përzgjedhura të Bashkimit Evropian, federalizmit fiskal në vendet e përzgjedhura të BE-së, koordinimit të politikës fiskale në BE, qëndrimit institucional të Sistemit Monetar Evropian, Politikës Monetare të Bankës Qendrore Evropiane, mekanizmit të kursit të këmbimit e kështu me radhë.

- **E Drejta Tregtare**

Qëllimi i lëndës mësimore është që studentët të fitojnë njohuri themelore të së drejtës afariste. Në këtë mënyrë, studentët njohohen me: - Rregullat juridike për kryerjen e aktivitetit të biznesit; - Mënyrën e organizimit të subjekteve afariste; - Kushtet për krijimin dhe regjistrimin e subjekteve afariste dhe tregtarin individual, si dhe me mënyrën e përfundimit të subjekteve afariste; - Mënyrat për themelimin e raportit afarist-juridik; - Kushtet për krijimin e këtyre marrëdhënieve, efektet dhe pasojat; - Punën me letrat me vlerë: mënyrat për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, mënyrat e mbrojtjes së subjekteve afariste nga konkurrenca e joluajale, me mënyrat e mbrojtjes së konsumatorëve, etj.

- **Teoria e Lojës dhe Strategjia e Biznesit**

Kjo lëndë fokusohet në metodat analitike që rrjedhin nga teoria e lojës, e cila ofron një kornizë rigorozë analitike për strukturimin e situatave konkurruese, identifikimin e alternativave dhe një zgjedhje mes tyre. Qasja themelore, do të jetë të eliminoj kompleksitetin e biznesit dhe më tej të përdoren mjetet e siguruara nga teoria e lojës për të analizuar këto pjesë dhe pastaj të mblidhen pjesët në një kuptim koherent logjik. Qëllimi është që të bëhen vendimmarrës më të mirë strategjikë kur ballafaqohen me sfida konkurruese. Qëllimet kryesore, do të jenë përdorimi i koncepteve dhe mjeteve të teorisë së lojës për të identifikuar, diagnostikuar dhe analizuar sfidat konkurruese me të cilat përballen firmat në mjedis dinamik dhe të zbatojnë konceptet dhe mjetet e teorisë së lojës për të zhvilluar strategji që do t'u japë atyre një avantazh konkurrues.

- **E - Tregtia**

Qëllimet e programit të lëndës: - Kuptimi dhe zbatimi i koncepteve të tregtisë elektronike - biznesit elektronik. - Identifikimi i nevojave të biznesit për adaptim të ndryshimeve konstante dhe të vazhdueshme në mjedisin dhe të rëndësishë së inkorporimit të teknologjisë në proceset më të rëndësishme të biznesit. - Përmirësimi i efikasitetit të tyre aktual operativ për t'u transformuar në avantazh konkurrues. - Zhvillimi i planifikimit strategjik, administrativ dhe operativ për bizneset e reja, apo përmirësimi i planifikimit aktual me teknologjitë e tyre. - Të shpjegohen: rritja e e-biznesit deri më sot, koncepti biznes-konsumator dhe modeli biznes-biznes, duke përdorur teori relevante nga biznesi, menaxhmenti dhe shkencat shoqërore. - Të shqyrtohet: ndërveprimi midis trendeve teknologjike dhe biznes-konteksti social i e-biznesit, duke përfshirë edhe difuzionin e rrjeteve sociale dhe ndodhjet në ueb 2.0.

- **Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit**

Nëpërmjet kësaj lënde jepet një hyrje e gjerë për sistemet e informacionit edhe prizma organizative dhe sociale. Qëllimi është që studentët të fitojnë një ekuilibër të duhur të perspektivave teknike dhe organizative, që do të shërbejnë si bazë për studime të mëtejshme në këtë fushë.

- **Ekonomia e Mmjedist Jetësor**

Lënda është dizajnuar për të siguruar një kuptim themelor të fenomeneve ekonomike dhe për terminologjinë globale universale ekonomike. Ndiqen dhe analizohen qasjet praktike, që mundësojnë të arrihet te pasqyrimi vetanak për angazhmanet e mundshme afariste në fushën e aktivitetit zhvillimor, të ndërtimit, planifikimit dhe zhvillimit të hapësirave ndërtimore të qytetit. Gjatë ndërtimit degradohet mjedisi natyror. Pa ndërtime nuk mund të merret me mend aktiviteti ekonomik, por ai e degradon hapësirën dhe në masë të madhe zvogëlon cilësinë e jetës. Pikërisht zhvillimi i kësaj lënde jep mundësi për të gjetur një ekuilibër mes nevojave të zhvillimit dhe rritjes së standardit material dhe mjedisit jetësor të kuptuar si një mjedis natyror, i cili ka nevojë që në shtigje afatgjata ta ruajë një cilësi të mirë dhe e cila nuk e kërcënon cilësinë e jetës së ekosistemeve. Komponentët zhvillimorë japin dimension dinamik pa të cilin qasjet e thjeshtuara, do të ishin të papërdorshme. Teoria për zhvillimin urban është pjesë integrale e çdo politike makroekonomike. Nuk është e mundur të flitet për stabilitet makroekonomik, ose për pikën e ekuilibrit të kërkesës dhe ofertës në qoftë se nuk merren parasysh elementet dinamike të zhvillimit të bazës ekonomike dhe elementet më dinamike të punës së objektivizuar dhe kontributi shkencor i progresit teknik dhe teknologjik, si dhe investimet si zhvillim motorik i zhvillimit dhe ndikimi të cilin zhvillimi e ka në variablat e tjerë makroekonomikë, sidomos kur dihet se proceset kryesore motorike të zhvillimit ndodhin në zonat urbane. Qëllimi kryesor është të krijohet një njohuri normale për ndikimin e investimeve në zhvillim, por edhe në stabilitetin makroekonomik të çdo

ekonomie kombëtare. Ato u japin frymë bizneseve, mundësojnë funksionim normal të tregut të patundshmërive dhe blerjen e patundshmërive. Bizneset në qytete ndikojnë në formimin e atraktivitetit të lartë të hapësirës, por shqyrtimi i trajtesave teorike për modelimin e sistemeve urbane është me dobi të madhe për çdo profilim të efikasitetit urban. Mënyra e menaxhmentit dhe financimit të ndërtimit është pjesë integrale e kësaj lënde dhe jep informacione themelore për ecurinë, zhvillimin multidimensionalitetin dhe punën e ekipore (arkitektët, urbanistët, ekonomistët, administratën e qeverisjes vendore, shërbimet më të larta shtetërore, standardet, siguria, estetika e hapësirës, hortikultura, siguria e funksionimit të sistemeve të veçanta në kompleksin urban, ruajtja e e atraktivitetit dhe vlerës etj.)

- **Ekonomia e Fondeve Publike**

Qëllimi kryesor i lëndës Ekonomia e Fondeve Publike është t'i ndihmojë studentët t'i kuptojnë dallimet mes sektorit publik dhe privat. Në këtë kontekst, shpjegohen logjika, organizimi dhe mënyra e funksionimit të sektorit publik në nivel botëror dhe në Maqedoninë e Veriut.

- **Zhvillimi Ekonomik Lokal**

Lënda synon të fokusohet në teorinë e mëdha të zhvillimit ekonomik lokal. Të shqyrtohen konceptet kryesore dhe mjetet analitike për planifikimin e zhvillimit ekonomik lokal.

- **Ekonomia Globale**

Lënda Ekonomia globale ka për detyrë t'u mundësojë studentëve ta bëjnë mozaikun për pamjen e botës bashkëkohore dhe t'i kuptojnë karakteristikat e marrëdhënieve ekonomike, që ekzistojnë brenda saj. Për këtë qëllim materia të cilën e mbulon kjo lëndë është ndarë në disa kapituj themelorë, siç janë: 1. Teoritë themelore të politikave të tregtisë ndërkombëtare, 2. Llojet e politikave tregtare dhe instrumentet e tyre, argumentet për dhe kundër zbatimit të tyre dhe rëndësia e roli i rregullativës së tregtisë ndërkombëtare; 3. Karakteristikat e trendeve moderne ekonomike në ekonominë ndërkombëtare; 4. Karakteristikat e sistemit modern ndërkombëtar monetar; 5. Tregu i kapitaleve; 6. Bilanci i pagesave dhe 7. Problemet me të cilat ballafaqohet procesi i globalizimit.

- **Ekonomia e Sigurimeve**

Përmes kësaj lënde jepet kuptimi themelor për menaxhmentin e sigurimit. Studentët i përpunojnë aspektet teorike dhe i fitojnë shkathësitë dhe dituritë e nevojshme në sferën e menaxhmentit të sigurimit. Në kuadër të kësaj lënde janë përfshirë shkathtësitë themelore që përdoren në organizatat moderne, të cilat janë të lidhura me logjikën e proceseve të sigurimeve, planifikimit financiar, elementeve të sigurimeve, llojeve të sigurimeve, etj. Vlerësimi është shkathësi, e cila nevojitet për të gjithë menaxherët dhe për të gjitha disiplinat. Prandaj, kujdes i veçantë i kushtohet drejtimit të mjeteve të qeverisjes, qeverisjes me riskun nga sigurimi, shfrytëzimi i teorisë dhe modeleve të gjasës për drejtimin efikas me rrethimin e veçantë të shoqatave të sigurimeve, etj.

- **Sistemet Ekonomike dhe Politike**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është njohja e sistemit ekonomik, si një nënsistem i sistemit shoqëror e politik. Shtyllat kryesore të sistemit ekonomik - strukturat e tregut, institucionet, sistemi kooperativ, si edhe mënyra e funksionimit të tyre në të gjitha nivelet e pushtetit. Sistemet krahasuese ekonomike, para së gjithash janë ato të sistemeve funksionale të tregut kryesisht nga vendet anëtare të BE-së.

- **Ekonomia e Sjelljes**

Qëllimi i këtij programi është të studiohen faktorët socialë, kognitivë dhe emocionalë të vendimeve ekonomike individuale dhe institucionale, si dhe pasojat e ndryshimeve të çmimeve e tregut, fitimet dhe shpërndarja e burimeve. Modelet e sjelljes janë integruar nga teoria ekonomike dhe mbulojnë një gamë të koncepteve, metodave dhe fushave kërkimore.

- **Menaxhimi i Portfolios**

Qëllimi i kësaj lënde është që të shqyrtojë teorinë dhe praktikën e menaxhimit të portofolit. Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje ta përdorin informacionin në dispozicion mbi tregjet financiare, si në nivelet makro, ashtu edhe në ato mikro. Studentët, do të njihen me grupet kryesore të investitorëve, me objektivat dhe kufizimet e investimeve të tyre dhe si të zotërojnë aftësitë praktike në menaxhimin e investimeve, duke formuar pritjet e tregut të kapitalit dhe parashikimin e aktiviteteve të tregjeve.

- **Financat Personale**

Lënda FINANCAT PERSONALE ofron një hyrje praktike në menaxhimin financiar personal. Duke përdorur një strukturë, respektivisht një qasje hap-pas-hapi, i ndihmojmë studentët të mësojnë se si të kursejnë dhe investojnë, të menaxhojnë me kreditë studentore, të përllogaritin tatimet, të reduktojnë borxhet me kartelë kreditore dhe të planifikojnë për të ardhmen. Skenarët e jetës reale, që mbulojnë një gamë të gjerë të sfidave financiare, ua

mundëson studentëve të vlerësojnë rëndësinë e koncepteve kyçe, përfshirë edhe këshillat e dobishme nga ekspertët e financave personale, për t'i ndihmuar ata për t'i aplikuar këto koncepte në jetën e tyre. Shembujt e ndryshëm matematikor, do të ilustrojnë qartë rëndësinë kritike për arritjen e qëllimeve financiare afatgjate - përmes investimit. Lënda në fjalë i angazhon studentët dhe e fokuson vëmendjen e tyre mbi konceptet kritike, si të nevojshme për të pasur sukses në zotërimin dhe menaxhimin me mençuri të burimeve financiare gjatë gjithë jetës së tyre.

- **Ekonomiksi Menaxherial**

Qëllimet e programit të lëndës: - T'ju mundësojë studentëve t'u qasen problemeve menaxheriale vendimmarrëse, duke përdorur mendimin ekonomik; - Të paraqesin tema të praktikave të biznesit, duke përdorur një qasje analitike, duke përdorur ekuacione dhe qasje numerike.

- **Ekonomia Industriale**

Kjo lëndë ofron një hyrje në teorinë aktuale (të tanishme) dhe një hulumtim empirik në ekonominë industriale. Fillon me shqyrtimin e strukturës së brendshme të firmave. Pas kësaj, lëviz drejt analizës së aspekteve të ndryshme të ndërveprimit strategjik midis firmave dhe përcaktuesve të strukturës industriale. Së fundi, merret (diskuton), me rolin e politikës në kontekst të konkurrencës, me rregullativën dhe politikën industriale. Theksi i kësaj lënde, do të jetë në të kuptuarit se si njohuritë (mjetet) teorike mund të përdoren për të analizuar çështjet reale botërore. Teoria, do të përballet me prova empirike dhe do të diskutojë implikimet e saj në politikën publike dhe strategjinë e biznesit.